

Dalës-lizazna

Nr. 1-54
Br.

Data 19.06.2022
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.24.03.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Katarina Adjancic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete, drejtorët komunal, Haki Jashari, drejtor i QKMF-së, përf. e KFOR-it dhe Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së për marrjen e vendimit për rritjen e të hyrave vetanake në vlerën prej 225,251.42 €,
4. Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në vlerën prej 368,930.24 €,
5. Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.-I-94, e dt.29.06.2018 për tarifa, gjoba dhe ngarkesa komunale
6. Shqyrtimi i kërkesës për plotësim ndryshimin e Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 14 vota për 5 vota kundër dhe 2 vota abstenim.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesja – Lidhur me miratimin e procesverbalit kemi një kërkesë nga LVV-ja, z.Sami Ahmeti, i cili ka kërkuar që në procesverbal të evidentohen emrat e anëtarëve të Kuvendit për çdo votim. Kjo nuk ka qenë praktikë e mëhershme sepse ligji nuk e jepë ashtu dhe sipas LVL-së, neni 48, thotë se nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht me këtë ligj vendimet e Kuvendit të Komunës, aprovohen me shumicën e anëtarëve

të pranishëm dhe votojnë. Sipas nenit 49, procesverbalet mbahen në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve nga të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës dhe aprovohen në takimet e radhës. Po ashtu, Rregullorja e punës së Kuvendit e specifikon neni 39, pika 2, votimi në parim është i hapur përveç për çështje të caktuara me dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren. Nën 3, votimi i hapur bëhet me ngritje të dorës, ndërsa sa i përket procesverbalit me këtë Rregullore neni 46, thotë: “Mbi bazën e procesverbalit nxjerret ekstrakti i procesverbalit, i cili përveç tjerash përmban datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, kohën e fillimit, emrin, mbiemrin e kryesuesit të mbledhjes, pjesëmarrësit, pikat e rendit të ditës, esenca e diskutimeve, rezultatet numerike të votimit dhe kohën e mbarimit të mbledhjes”. Pika 5, e nenit 46 e Rregullores së punës së Kuvendit parashehë se grupi i anëtarëve, ose anëtari mund të kërkojë që në ekstrakt të procesverbalit të evidentohet veçimi i tyre gjatë votimit në çështje të caktuara. Mendoj se vetëm në çështje të caktuara parapakisht dakordohemi që të evidentohen emrat se kush çfarë vote po jepë.

Sami Ahmeti – Tashmë, ju e paraqitët se e kemi një sistem të ri të votimit, që kjo do të ishte shumë më e lehtë edhe për zyrtaren e Kuvendit komunal, që këto gjëra të evidentohen. Ne vazhdojmë të qëndrojmë në atë se neve, na intereson çdo gjë që votohet prej neve, të paktën e emrat tonë të figurojnë, e nëse jo vazhdojmë me atë që e kemi thënë më heret se procesverbalet nuk i miratojmë.

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 12 vota për, 7 vota kundër dhe 1 votë abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për marrjen e vendimit për rritjen e të hyrave vetanake në vlerën prej 225,251.42.

Zarife Behluli – Ju sqaroj se në faqen e parë i keni mjetet ku kanë mbetë nga viti 2021. Planifikimi i buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2021 ka qenë 950,180 €. Ne kemi arritë me i tejkalue 225,251.42 €, dhe total të hyra nga tatimet, taksa e tarifa që kanë pasë me i pague qytetarët dhe bizneset janë 105,098.12, ndërsa nga gjobat dhe denimet në trafik pas çdo 3 mujori alokohen nëpër Komuna. Në mbylljen e vitit këto janë alokue në janar janë 120,153 €. Totali 105,098.12 €, dhe 120,153.30 €, bëjnë 225,251.42 €. Vendimi i parë duhet të merret për rritjen e të hyrave vetanake në këtë vlerë.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar jemi dakord për rritjen e të hyrave, që është një dukuri e mirë, por e pyes drejtoreshën pse bash fikso kështu, a bën dhe a kemi hapësirë me rritë më shumë.

Zarife Behluli – Përgjegjet se edhe unë do të isha më e lumtura sikur ti kishim 500,000 €, me bë rritje të të hyrave, por kaq janë që janë bërë pagesa.

Valon Svirca – Kur jemi te bartja e mjeteve në sektore të caktuara, ne si LVV propozojmë që të ndahet shuma prej 10,000 €, të hyra vetanake për shpenzimin nëpër shkolla. Duke ditur se Obiliqi është vendi me më së shumti raste sociale për kokë banori në Kosovë, në emër të grupit të anëtarëve të Kuvendit komunal të LVV, propozoj nga Kuvendi komunal që kjo shumë të ndahet prej 10,000 €, për shpenzimet që iu kërkohet nxënësve për mbarëvajtje të procesit mësimor. Të gjithë jemi dëshmitarë se në shkollat tona pothuajse çdo javë iu kërkohen nxënësve të holla simbolike për nevoja të ndryshme që lidhen direkt me procesin mësimor. Rasti më i freskët është në shkollën në Sibofc, prandaj për të iu shmangë këtyre kërkesave financiare nga nxënësit, propozoj që ta mbështetni propozimin tim dhe të ndahen këto mjete financiare për burimin e këtyre shpenzimeve.

Ibush Mjekiqi – Specifikisht kisha dashtë ta dijë cilat janë ato shpenzime, që 10,000 €, ti drejtojmë në mbulimin e atyre shpenzimeve. Më fal z.Valon, unë nuk e di se cila është arsyeja që nxënësve në Sibofc, iu janë kërkuar mjete, ndoshta dikush e din, por unë nuk e di.

Valon Svirca – Përgjegjet se pothuajse çdo ditë iu kërkohen shuma simbolike 1 €, 2 €, ose 50 centë, psh në shkollën në Sibofc iu është kërkuar për zgjerim, ose zmadhues si me thënë dhe ju kërkohet ndoshta për diçka edhe më banale psh për shpuza. Tash, normal është dashur me pasë një teknologji të fundit, e jo shpuza e gjëra tjera.

Ibush Mjekiqi – Në kuadër të buxhetit që është aprovuar për këtë vit janë 5 kategori dhe në mesin e tyre është edhe kategoria për mallra dhe shërbime e cila e parashehë furnizimin për të gjitha shkollat me mjete,

ose me pajisje të nevojshme për mbajtjen e mësimit. Ne do verifikojmë bashkarisht këtë çështje përmes Drejtorisë së Arsimit dhe nëse, ka mungesa do ta shikojmë se ku është problemi.

Valon Svirca – Unë e mora vetëm si shembull shkollën në Sibofc, tash ka pothuajse gjithkund. Për këtë arsye kisha dashtë, që së paku me ua lehtësue që mos me u ngarkue me 1, ose 2 €, sepse pa marrë parasysht mendoj se është shumë për nxënësia.

Zarife Behluli – Unë kisha me propozue me marrë vendim për rritjen e të hyrave vetanake në vlerën prej 225,251.42 €, pastaj zgjerohemi te pjesët tjera.

Ajet Berisha – Këto, të hyra kanë ardhë më tepër se që është planifikue me të hyrat vetanake dhe meqë, është më tepër këto nuk janë planifikue me u shpenzue. Tash duhet me bë rritjen sepse është tejkalue nga 950,000 €, tash është mbi 1 milion. Tash, ne duhet me i planifikue se ku me i dërgue, që fillimisht marrim vendim për rritje pastaj, ku kemi me i dërgue. Në kuptimin se ku kemi me i dërgue erdhi edhe propozimi, që pajtohem me z.Valon, sepse ju thatë me marrë këtë vendim, por njëkohësisht e keni bërë edhe shpërndarjen. Mendoj se në shpërndarje ndoshta, është mirë që me i dhënë mundësi pak më tepër anëtarëve të Kuvendit, që ku i kanë brenat e vetme me propozue, në të kundërtën një pasqyrim se nga kanë me shkue mjetet veç e keni ofrue.

Xhelal Krasniqi – Fjala, ishte për shkollën “Migjeni” në Sibofc dhe unë jam punëtor aty. Deshta vetëm një sqarim për aktivitetet jashtëkurikulare psh vizitat e ndryshme që kanë të bëjnë me nxënësit që nuk organizohen brenda shkollës atëherë kërkohet participimi i nxënësve. Ndërsa, në gjërat që kanë të bëjnë me procesin mësimor nuk iu kërkujmë mjete nxënësve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për dhe 5 vota abstenim e aprovuan Vendimin për tejkalimin e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2021.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Për një sqarim më detal rreth bartjes së mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022, në vlerën prej 368,930.24 €, fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli – Tani, shkojmë me mbetje të mjeteve buxhetore nëpër vija buxhetore ku kanë mbetë. Për Drejtorinë e kulturës, blerja e inventarit 51 €, nga ndriçimi publik 512.52 €, renovimi i objekteve QKMF, AMF dhe QMF 5,047.74 €, pajisje elektrike në QKMF, AMF dhe QMF 1,320 €. Pastaj, shtruarja e rrugëve me zhavorr prej fondit 22, 5.90, ndërtimi i shtatoreve në Obiliq 25.40, ndërtimi i ankeseve shkollore në Obiliq 47.30, kalojnë në projektin ndërtimi i bibliotekës 22,855.19. Në total te biblioteka 29, 865.48 €, dhe këto ishin mbetjet e mjeteve nëpër projekte kapitale. Te planifikimi mjedisor mjetet e mberura në mallra dhe shërbime administrata 40 €, DSHPE-ja 135 €, kujdesi primar shëndetësor 2 €, Arsimi çerdhja 3,386.42 €, Zyra e Kryetarit 143.50 €, mjetet në mjedis që janë 33.85. Prej fondit 22, administrata 1,418.13 €, DSHPE-ja 5,096.17 €, Zyra e Kryetarit 1,018.45 €, mjetet e mjedisit që kanë mbetë 22.25, që në total mjete prej mallrave dhe shërbimeve te projekti mbjellja e drunjëve 11,295.77 €. Prej shpenzimeve komunale për DMM-në, mbjellja e drunjëve, kujdesi primar shëndetësor 3,000 €, çerdhja 1,000 €, Arsimi fillor 2,000 €, mjetet që janë në mjedis 19,6095 €, DSHPE-ja 44,174.50 €, që në total mjete 69,849.50 €. Në total prej mallrave dhe prej komunalive në projektin mbjellja e drunjëve janë 81,145.27 €. Për Drejtorinë e bujqësisë, nga subvencionet te Zyra e Kryetarit 245 €, DSHPE-ja 14,795 €, buxheti 5,100 €, Arsimi 40 €, mjetet e bujqësisë 5,650 €, që në total fondi 21,25,831.19. Nga fondi 22, Zyra e Kryetarit 99.27, DSHPE-ja 58.70, Arsimi 40 €, mjete të bujqësisë që i ka 1,365.44 €, që në total në bujqësi janë 27,394.60 €.

Shaip Paloja – Unë kërkoi një sqarim se kolegu nga LVV-ja, e paraqiti një dukuri që nëse është ashtu, mendoj se është shumë e papranueshme për neve, që iu kërkohen mjete nxënësve për diçka që paguan Komuna, është e papranueshme. Mirëpo, njëkohësisht edhe kolegu z.Xhelal, që është punëtor e sqaroi pse merren ato mjete. Unë po kërkoi që këtu të dalë e vërteta se a ka të drejtë z.Valon, apo z.Xhelal, që neve të na sqarohet se cila është e vërteta.

Valon Svirca – Ne i kemi sms, që i kanë dërgue ose i kanë rue dhe nuk e kam thënë vetëm hajt ashtu.. Ndoshta, nuk është shumë e madhe, por është simbolike për një nxënës 1 €, 2 €, kërshu që për këtë e ngrita këtë çështje që së paku këto me i minimalizue dhe mos me pasë më.

Kryesuesja – E shpjegoi edhe Nënkryetari më heret sepse së bashku me drejtorin e Arsimit dhe mësimdhënësi z.Krasniqi, i cili punon në atë shkollë do ta hulumtojnë bashkarisht se çka është në pyetje.

Zarife Behluli – Dua, të ju sqaroj për subvencionet në bujqësi nga fondi 21, janë 40 €, dhe nga fondi 22, janë 40 €, sepse tash ne dojmë me i bartë prej rritjes së të hyrave 150,000 €, dhe aty ku barten nuk guxon me i marrë.

Sami Ahmeti – Ne si LVV, e kuptojmë se nganjëherë është e pamundur realizimi njëqind për qind i buxhetit komunal, por bazuar në vitet paraprake ky vit është pak sa më i mirë në nivelin e harxhimit të buxhetit. Kjo, për arsye se viti që shkoi ishte vit i zgjedhjeve lokale dhe qëllimisht ishin lënë që projektet e caktuara të përfundonin rreth muajve zgjedhor. Shumë prej këtyre projekteve përmbajnë në vete dyshime korruptive për të cilat dhe me të cilat do të merren organet e drejtësisë. Mirëpo, në kohën që jemi qyteti më i varfër dhe me teprue 370,000 €, kjo s'don koment për faktin që kemi një sistem shëndetësor me mungesa qenësore dhe të teprojnë 370,000 €, s'don koment. Kur kemi sistem arsimor dhe shkolla me mungesa të ndryshme ashtu qysh e ceku z.Valon, ku nuk kanë as inventar, as kabinete, madje as material administrativ dhe të teprojnë 370,000 €, mendoj jo vetëm që është pazotësi, por edhe nënçmim për qytetarët, e mos të flasim për mungesat tjera qoftë në rrugë, qoftë në institucione, qoftë edhe në nivele të sigurisë. Thjeshtë, çdo gjë që ka lidhje me buxhet ne nuk do ta votojmë sepse jo vetëm që nuk ju besojmë, por thjeshtë kemi dyshimet tona se po keqpërdoren mjetet, apo thënë më thjeshtë ato po vjedhen. Dyshimet tona kanë bazë në përpjekjet tuaja për të mbajtur largë transparencën e transaksioneve të pagesave të parasë publike.

Ibush Mjekiqi – I nderuar z.Ahmeti, jemi në Kuvend dhe nuk jemi në rrugë, prandaj kurseu prej fjalive. Etiketimet të cilat i bën nuk i bën nder këtij Kuvendi, prandaj fjalët e rënda që po i përdorë ke kujdes sepse nuk është e vërtetë. Ti nuk je ai që e vlerëson këtu, se kush është hajn, e kush nuk është prandaj kurseu të lutem.

Sami Ahmeti – Ato që i thashë i përsërisë, jo njëherë por edhe pesëqind herë sepse dyshimet jeni ju vetë duke i ngritë. Me dhjetëra kërkesa bëhen në drejtimin tuaj për transparencë të parasë publike dhe ju i fshehni ato, prandaj derisa është ashtu ne nuk besojmë.

Ajet Berisha – Duke e parë rritjen e të hyrave, apo vendimin që e morëm 225,000 €, për rritjen e hyrave vetanake, në kuptimin e asaj që janë tejkualar mendoj se bartja është e vogël. Pra, është dikund rreth 143,000 €, për me ardhë në total kur të mbledhen me vendimin që u shtuan të hyrat vetanake prej 368,000 €. Është paprecedent, por po e them se është hera e parë në Kuvendin komunal, që jam hera e katërt, ose e pestë si anëtarar i Kuvendit, që kisha pasë dëshirë që këto mjete të jenë më shumë, jo 368,930 €, por kisha dashtë të mbërrin te milionëshi. Kjo, jo pse është dëshira ime, por duke i kalkulue të hyrat e prezentuara më heret në raportin vjetor, duke i kalkulue shpenzimet që kanë kalue përmes zyres dhe aktivitetit të Zyres së Prokurimit, fatkeqësisht nga ajo që delë praktike nga Zyra e Prokurimit kanë kaluar bashkë me bartjen që sot po e bëjmë 3 milionë e 677.248 €. Ndërsa, përmes Zyres së Prokurimit është dashtë të kalojnë 6 milionë e 129.29 centë. Në rast se i zbresim këto, do të thotë këtu është përfshirë edhe bartja mjetet që mbeten, ose Komuna, i humbë për vitin 2021 që janë 2 milionë e 451,752. €. Unë për këtë arsye kisha dashtë që kjo bartje të jetë shumë më shumë më e madhe se sa është sepse nga ky konstatim dhe nga raportet e juaja dhe nga raporti financiar delë se Komuna në vitin 2021, ka humbë 2 milionë e gjysmë. Komuna, nuk ka arritë me i shpenzue 2 milionë e gjysmë, gjë që nga ai buxhet i bjen dikund 30 %, të mjeteve që ka pasë me i shpenzue i ka humbë, që është paaftësi e kësaj Komune për me i shpenzue. Këtë, që po e them unë ose keni gabue ju në raportet e juaja, ose raporti i auditorit do ta tregoj këtë që po e them. Gabimin që unë mund ta bëjë është se nuk e kam vetëm një të dhënë bartjen që e keni bërë në vitin 2021, atë shumë nuk e di. Në rast se ajo shumë është më e madhe, fatkeqësisht kjo mbetje mundet ende me u rritë, jo 2 milionë e gjysmë, por do të shkoj edhe më tepër. Kjo, është dashtë me ndez alarmin që Komuna me bë planifikime më të sakta dhe me i rritë kapacitetet shpenzuese sepse është shqetësuese për një Komunë, si Komuna e Obiliqit, që deri tash për afërsisht 2 milionë në vit i ka humbë, tash kjo është rritë edhe pse ka qenë vit elektorale nuk keni arritë me i shpenzue 2 milion e 451,000 €.

Xhelal Krasniqi – Kur jemi te bartja e të hyrave vetanake, unë kisha pasë një shqetësim duke parë inflacionin ekonomik dhe rritjen e çmimeve të artikujve bazë, unë në çdo takim me qytetarë temë bazë është

rritja e papërballueshme e çmimeve të artikujve ushqimor. Pra, në emër të grupit të asambleistëve të AAK-së dhe LB-së, në Obiliq, kërkoj që të iu dilet në ndihmë familjeve me asistencë sociale në Komunën tonë, me një pako ushqimore në 3 muajt e ardhshëm për derisa Qeveria e Republikës së Kosovës, të dalë me një rekomandim, apo udhëzime se si të iu ndihmohet këtyre familjeve me asistencë sociale sepse ne e dijmë se shporta e tyre është zvogluar me artikujt bazë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 8 vota kundër e aprovuan Vendimin për bartjen e mjeteve buxhetore në vlerën prej 368,930.24 €.

Xhelal Krasniqi – Ne po flasim për kategorinë më të ndjeshme sociale edhe pse sot është bërë bartja e mjeteve në vlerë prej 368,930.24 €, kërkesa e jonë nuk u përfill nga Ekzekutivi edhe pse kjo nuk u trajtua me ndjeshmëri siç është edhe vet kjo kategori.

Kryesuesja – Kjo është çështje e Drejtorisë, është kodi buxhetor, është vija e ndarë për pako ushqimore, siç e kemi bërë edhe në vitet paraprake. Kërkesën tuaj drejtoresha e shëndetësisë do ta shikoj bashkë me Kryetarin për mundësitë e realizimit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.-I-94, të dt.29.06.2018, për tarifa, gjoba dhe ngarkesa komunale.

Sami Ahmeti – Qdo Rregullore dhe çdo dokument që delë në debat publik, ne si grup parlamentar e mbështesim dhe aq më tepër edhe do të provojmë që të japim kontributin tonë qoftë në debat publik, qoftë edhe në këtë seancë.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.-I-94, të dt.29.06.2018, për tarifa, gjoba dhe ngarkesa komunale.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e kërkesës nga DMM-ja, për plotësim ndryshimin e Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet konfirmimin ligjor nga MFPT, për shfuqizim të vendimit nr.-I- 16, i dt.04.02.2022, për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Sami Ahmeti – Për këtë vendim biseduam edhe në mbledhjen e KPF-së, që do të thotë se me automatizëm është shfuqizuar vendimi paraprak edhe pse edhe vendimi ynë paraprak ka qenë copy paste, i tarifave të vitit 2021. Kjo, shkon me automatizëm, por unë nuk mendoj që ka qenë muaji nëntor, e specifikon dokumenti që muaji nëntor është ai që duhet me u vendosë tarifata, mirëpo para 30 nëntorit. Fakti që ka pasë zgjedhje Kuvendi ka funksionue, por fokusi ka qenë diçka tjetër dhe ne në këtë pikë të rendit të ditës, do të abstenojmë.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për dhe 5 vota abstenim e aprovuan Vendimin për shfuqizimin e vendimit nr.-I- 16, i dt.04.02.2022, për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga MMPHI-ja, për shfuqizim të vendimit nr.-I-17, të dt.04.02.2022, për plotësim ndryshimin e vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familjet që janë raste sociale.

Enver Gashi – Ne me këtë vendim në këtë mandat vetëm kemi bërë plotësim ndryshim, por është marrë edhe një vendim më heret prej Kuvendit, që është kthyer nga MAPL-ja, si vendim i ligjshëm. Po ashtu, ka pasë ndryshime edhe në ligj, edhe në Rregullore dhe tash ne nuk jemi fajtor që e kemi formuar këtë Komision. Ne jemi për shfuqizimin e këtij vendimi dhe me i dhënë kompetenca sipas ligjit Kryetarit të Komunës, që ti caktoj këto Komisione.

Sami Ahmeti – Para se të hyj në temë unë kam një pyetje për këtë vendim dhe për vendimin që pason. Në mbledhjen e KPF-së, kërkoja që vërejtjet e zyrave ligjore të Ministrive, të na dërgoni në mënyrë që edhe ne

të mund të japim kontributin tonë. Kryesuese, pse nuk na i dërguat materialet, nga çka po keni frigë, kush po ju frigon në punën e juaj.

Kryesuesja – Përgjegjet se paraprakisht ne e diskutuam në KPF dhe ju thatë nëse, është ligjërish e lejuar kishim pasë dëshirë me i pasë ne këto vendime. Unë jam konsultuar me Zyren ligjore, e cila tha se nuk e kemi obligim, nuk është praktikë dhe nuk iu lejohet sepse Ministria kryesisht i drejtohet Kryetarit të Komunës dhe kryesueses së Kuvendit. Ju mund ti gjeni në faqen zyrtare të Ministrisë, ku të gjitha janë të publikuara dhe nuk ka asgjë të fshehtë.

Sami Ahmeti – Realisht nuk është që nuk e kemi obligim sepse kur vendoset një pikë e rendit të ditës, ne duhet të dijmë se për çka kemi me bisedue. Për faktin, që nuk na dërguat unë iu drejtova Ministrisë dhe këto dokumente i kam sikurse edhe krejtë kërkesat tjera, çka mundemi që nuk po i marrim këtu, ne i marrim dikund tjetër sepse është rrjeti dhe ka mundësi me i marrë. Megjithatë, unë po e shohë një nivel të papërgjegjësisë dhe një nivel të nënçmimit tonë sepse ne duhet të dijmë se për çka po bisedojmë. Është marrë një vendim dhe kolegu tha paraprakisht se kanë ndryshue ligjet, që nuk është e vërtetë sepse ky ligj, këto Rregullore dhe këto Udhëzime administrative, janë prej vitit 2010. Kjo, e nxjerrë që edhe vendimet e Kuvendit që ka formue Komision, paraprakisht kanë qenë jo të ligjshme, për çka se atëherë në Ministri kanë qenë njerëz të cilët kanë qenë alergjik ndaj leximit dhe nuk iu ka interesue vetëm i kanë përcjellë mëtutje. Sido që të jetë, ne do të abstenojmë edhe për këtë vendim dhe unë konsideroj se është një përpjekje, jo që nuk është ditë prej Kryetarit apo prej stafit këtu, që vendimet për këto çështje është dashtë me i marrë Kryetari, por është tendencë e Kryetarit, që me i ikë përgjegjësisë dhe përgjegjësi kur është te këto aspekte me ia hudhë Kuvendit. Unë nuk e di se a ka në këtë Komunë, zyrë ligjore, apo a ka ndonjë zyrtar, ndonjë juristë që din me lexue.

Kryesuesja – Unë kisha pasë dëshirë të keni kujdes kur etiketoni njerëz sepse nuk është mirë.

Ajet Berisha – Pjesën kryesore e tha parafolësi z.Sami, për atë çfarë deshta me ngritë. Mirëpo, një diçka që është interesante ju po kërkon anulimin e një vendimi që ka kërkuë Ministria, ndërsa po thua se nuk është obligim me ua sjellë juve, që me i pa ju se në cilat pika është thirrë Ministria, pse duhet me anulue. Do të thotë është diçka e kundërta, nga ajo që po thoni. Nëse, ne duhet me anulue një vendim, është çështje e jona me i pa dokumentet, ndërsa ju e kemi obligim me na i dërgue, e jo me thënë nuk është obligim sepse çka me anulue unë kur nuk e di se çka po shkruan, ku është thirrë dhe ku kemi gabue. Këtu, Ministria neve po na thotë keni gabue si Kuvend, që në radhë të parë keni gabue ju që ia keni ofrue Kuvendit, pastaj kemi gabue ne sepse nuk kemi pasë informata. Ndërsa, ti po thua nuk duhet me ti sjellë, ti me i pa edhe në rast se gabon. E nderuar, dokumentat kur na i sjellni për votim, ne duhet me i pa se ku po bazohemi, ku po thirremi dhe qysh nuk e ke obligim, e ke fortë obligim ti me na i sjellë, e jo me thënë i ke në web faqe. Ti duhet mua me më pajisë me të gjitha dokumentet të cilat unë duhet me i shqyrtue, me i analizue dhe me veprue, me votue për, kundër, ose abstenim. E ke obligim, pikë. E dyta, pajtohem me atë që e tha z.Sami, dhe është çështje shumë e rëndësishme kur shefi i grupit të cilës parti jeni nuk e di të LDK-së, a tha se kanë ndryshue ligjet, jo, jo në bazë të Rregullores dhe thirrjes që e ka bërë Ministria, thotë Rregullorja nr.22/2010, që nënkutpon se Rregullorja nxjerret pas ligjit sepse ligji është ende më heret është 2010, e më heret. Kjo, do të thotë se edhe ato banesa që i keni dhënë ju, deri më sot i keni dhënë në mënyrë të kundërligjshme, duke mos u bazuar në ligjet që janë në fuqi, që është për banime specifike edhe aty keni veprue në kundërshtim, për atë edhe ua ka kthye.

Kryesuesja – Z.Berisha, ligjshmëria për Komisionet e tilla ka ardhë nga MAPL-ja, përndryshe nuk besoj se kishin funksionue Komisionet e tilla sepse neve na monitoron Ministria, kështu që nuk besoj se dikush bën shkelje të tilla. Varësisht në cilën Ministri adresohet vendimi dhe në cilat Udhëzime administrative thirren ajo është çështje komplet e Ministrive. Neve, na ka ardhë kjo dhe nuk jemi duke fshehë asgjë, të lutem shumë. Ne e dijmë shumë mirë që janë publike dhe nuk ka qenë praktikë e mëhershme me iu dërgue ligjshmëritë anëtarëve të Kuvendit. Unë kam pyet dhe më kanë thënë se nuk është obligative.

Ajet Berisha – Ju po kërkon ne me votue diçka që nuk e shohim hiç, nuk dijmë se çka është, ti po e lexon dhe unë me të besue ty çka po lexon. Fakti, që Ministria, nuk vepron e pagabuar këtë po e dëshmon edhe vendimi që ua ka kthye dhe kjo po tregon se atëherë ka gabue edhe Ministria edhe ju. Unë që 2 muaj e kam

bërë një kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë të një vendimi të këtij Kuvendi dhe nuk më ka kthye përgjegje, kjo Ministri në të cilën po thirrresh ti në MAPL, që e ka obligim ligjor mirë ose keq me ma kthye përgjegjen mua, por nuk ma ka kthye, dëshmitar e kam shefin e grupit të LVV-së. Problemi është mos u thirrë ti në atë se ata ligjshmërinë e kanë bërë mirë, nuk e kanë bërë mirë sepse edhe atëherë kanë gabue, edhe ju edhe Ministria.

Kryesuesja – Z.Berisha, nuk kontestohet ligjshmëria e Ministrisë, të paktën jo prej Kuvendit komunal sepse atje ka njerëz dhe juristë, ekspertë që merren me këtë çështje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 8 vota kundër e aprovuan Vendimin për shfuqizimin e vendimit nr.-I-17, të dt.04.02.2022, për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-67, të dt.25.04.2019, i Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familjet që janë raste sociale.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga MMPHI-ja, për shfuqizim të vendimit nr.-I- 18, të dt.04.02.2022, të Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta me anëtarë të rinjë.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për, 6 vota kundër dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin për shfuqizimin e vendimit nr.-I-18, të dt.04.02.2022, për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-102, të dt.04.08.2021, i Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta me anëtarë të rinjë.

Pika 8 e rendit të ditës

Labinot Mirena – Sot dua ta ngriti një shqetësim, që ne si shoqëri përballemi qdo ditë lidhur me numrin e madh të qenve endacakë, ku jemi të ekspozuar një rreziku vazhdimisht nga sulmi i tyre. Rrezik kryesor janë fëmijët që shkojnë në shkolla, në parqe dhe në fushat sportive duke i zhvillue aktivitetet fizike. Është mirë të shqyrtohet mundësia e sterilizimit të qenve endacakë si dhe vaksinimi i tyre duke shqyrtuar edhe mundësitë e bashkëpunimit me organizatat e ndryshme ndërkombëtare të kësaj fushe. Unë e kam edhe kërkesën e dytë, që është një vërejtje që ka të bëjë me kompaninë rajonale “Ujësjiellësi Prishtina” si dhe me DSHPE-në, ku gjatë intervenimeve në rrjetin e ujësjiellësit dhe kanalizimeve, nga ujësjiellësi po e dëmton infrastrukturën rrugore siç është prerja e afaltit, që nuk kthehet në gjendjen e mëparshme asnjëherë. Në fshatin Palaj, e kemi gjendjen e tillë te fusha sportive në kthesë aty dhe në përgjithësi në krejtë territorin e Komunës së Obiliqit. Po ashtu, e kemi edhe rr.”Adem Jashari” që është prerë në herën e fundit, kështu që kam kërkesa prej shumë qytetarëve dhe këto ishin 2 kërkesat e mia për sot.

Valon Svirca – Unë e kam një ankesë nga fshati Mazgit, prej lagjjes Bllaca, të cilët kanë telashe me rrjetin e kanalizimit, dikund janë afërsisht 6 shtëpi. Ata kanë kërkuar ndihmë prej Komunës, nëse ka mundësi për shkak se është rritë numri i shtëpive dhe është i papërballueshëm ai rrjet i kanalizimit, që ata e kanë vendosë me vetëfinancim. Unë e kam edhe një kërkesë, është mandati i tretë që gjatë fushatës gjithmonë premtohet në Mazgit të Ulët dhe të Lartë, transporti publik, pyes se kur mundet me u krye nëse, është projekt për mu krye sa më shpejtë sepse është një ankesë shumë e madhe e Mazgitit.

Ajshe Haliti Pllana –Unë nuk kam ndonjë kërkesë, por deshta me ditë lidhur me përgjegjet në kërkesa, do të thotë asambleistët vetëm i bëjnë kërkesat dhe drejtorët nuk e marrin mundin që me pasë një përgjegje. Unë qe 2 muaj e kam pasë një kërkesë për Arsimin dhe unë nuk bëjë kërkesa tjera, derisa të marrë një përgjegje, as nuk e marrin mundin me kthye një përgjegje, as nuk veprojnë diçka, çka është puna.

Kryesuesja – Të gjitha kërkesat që bëhen në Kuvendin komunal, adresohen te Drejtoritë përkatëse dhe ata në mbledhjen e radhës, në formën gojore ose në të shkruar besoj se ju kthejnë ndonjë përgjegje.

Ajshe Haliti Pllana – Ka 2 muaj, që e kam bërë kërkesën, as nuk është ndërmarrë kurgjë, as nuk më është kthyer përgjegja. Mirëpo, nuk pashë as përgjegjet tjera, që janë kthye psh ka qenë çështja e transportit z.Labinot që e bëri kërkesën në herën e kaluar dhe qytetarët non-stop po pyesin se çka u bë puna e transportit, por asnjë përgjegje unë nuk e pashë deri më tash.

Labinot Mirena – Unë pajtohem plotësisht me znj. Ajshe, ashtu është edhe për 2 kërkesat e mia, që i kam pasë në të kaluarën, as nuk kam asnjë përgjegje me shkrim, ose me iu paraqitë juve, si kryesuese për me na ardhë deri te na si anëtarë të Kuvendit komunal. Vërejtja është shumë me vend.

Kryesuesja – Shumica e drejtorëve janë prezentë këtu, që besoj se janë duke i shenuar pyetjet dhe kërkoj të paktën nga ata që në formën e shkruar, ose gjojore të kemi një përgjegje në seancën e radhës.

Albana Shillova Shalaku – Edhe unë kam një pyetje për Nënkryetarin e Komunës. Një vendim i Kryeministrit Kurti, i shkurtit të këtij viti i obligon organet e administratës shtetërore që gjatë vitit 2022, të plotësojnë kuotën për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në pajtim me Ligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e kësaj kategorie. Ajo që dua të pyes është se a do ta zbatoj këtë vendim Komuna e Obiliqit, që në konkurset e ardhshme të punësoj persona të kësaj kategorie.

Valbonë Beka – Unë e kam një kërkesë sa i përket buxhetit për shkolla, duke marrë parasysh se nevojat janë shumë të mëdha, sidomos po flas për shkollën “Ismail Dumoshi” që praktika profesionale sidomos në kohë pandemie është duke u mbajtur në kushte tejet të papërshtatshme. Duke marrë parasysh se shkolla ka edhe të hyra të veta, të cilat që sa vite nuk shfrytëzohen direkt prej shkollës tonë, do të thotë të hyrat tona. Gjithashtu, që 2 vjet prej Ministrisë, ka të ardhura këtu që janë vendosë dikund rreth 2 herë nga 38,000 €, veç për praktikë profesionale dhe kurgjë hiç nuk është bërë në atë shkollë për praktikë. Unë dua të di se ku janë ato mjete dhe pse nuk po investohen ato mjete, për çka janë të dedikuara.

Sami Ahmeti – Në mbledhjen e KPF-së, e ceka rëndësinë e raportimit të 3 drejtorëve, ose 3 Drejtorive dhe na premtuat që kërkesat tona do të adresohen dhe drejtorët do të vijnë dhe do të përgjegjen në pyetjet që unë i ngrita në mbledhjen e KPF-së. Sot nuk ka ndonjë përgjegje, apo nuk ka ndonjë dëshirë që ata të iu përgjegjen pyetjeve tona, këtë nuk e di. Unë e di sistemin e raportimit dhe qysh funksionon dhe e di që drejtorët i japin raport Kryetarit. Mirëpo, nuk do të ishte keq që edhe ata ndonjëherë me hapë gojën para neve këtu, ti shohim dhe ti bëjmë disa pyetje që ne i kemi përgatitë, që çdo ditë ballafaqohen qytetarët me këto. Sido që të jetë, në emër të grupit tonë e kemi edhe një kërkesë që i bashkangjitet kërkesës të asambleistit të IQO-së, apo tash nuk po di qysh me iu thënë që në seancën solemne me rastin e 24 vjetorit të epopesë së UÇK-së, që e bëri në lidhje me shtatoren e “Adem Jasharit”. Ne si grup parlamentar propozojmë dhe e mbështesim kërkesën e z. Lulzim, dhe në të njejtën kohë propozojmë që ajo shtatore të vendoset në një vend meritor, me një hapësirë të caktuar dhe ai vend ne mendojmë që është sheshi “Adem Preniqi”.

Kryesuesja – Drejtorët janë prezentë të 2 institucioneve dhe ju vetëm keni kërkuar, por nuk keni paraqitë ndonjë pyetje.

Ibush Mjekiqi – Është shumë e vërtetë se shqetësimi për qentë endacakë është jo vetëm në Komunën e Obiliqit, por është problem në nivel të vendit. Ne në vitin e kaluar kemi pasë një kontratë për trajtimin e këtyre qenve endacakë dhe vazhdojmë ta kemi, por nëse një plan ose strategji kombëtare për rregullimin e kësaj çështjeje nuk bëhet në nivel të vendit, të jeni të bindur se nuk kemi me mund me zgjidhë këtë problem. Është problem që duhet të zgjidhet në nivel kombëtar dhe përpjekjet tona për ngritjen e këtij shqetësimi në institucionet e ndryshme janë në vazhdimësi. Tash, i përgjegjem z. Valon, për lagjen Bllaca, në Mazgit, se ne do ta shikojmë arsyen pse ai kanalizim nuk është në funksion, apo ka problem sepse e kemi vijën buxhetore për realizimin e investimeve. Këtë çështje unë do ta adresoj te Drejtoria për infrastrukturë. Pastaj, ishte një pyetje për transport dhe ju e dini se transporti është një segment jashtëzakonisht i rëndësishëm për Komunën tonë. Unë nuk them se e kemi pasë vetëm ne, ose të tjerët premtim elektorale, por pavarësisht premtimeve transporti është një nevojë, problematikë që kërkon një qasje multidimensionale që të zgjidhet. Ne në Komunën tonë nuk kemi kompani për transport publik, por në takimet që Kryetari i ka pasë me ekipin e vet në muajt e fundit, është ngritë edhe ky shqetësim. Ne këtë problem mund ta zgjidhim bashkarisht me Komunën e Prishtinës, ky problem mendoj se në këtë vit do të zgjidhet. Ishte edhe një pyetje nga znj. Valbonë, që është e vërtetë se shkolla profesionale “Ismail Dumoshi” realizon të hyra që shkojnë në vijën buxhetore të Komunës dhe nuk është problem që juve, duhet të iu kthehet domosdoshmërisht, por kthehen përmes vijave të investimeve kapitale dhe të tjera. Mjete grumbullon edhe QKMF-ja dhe ato mjete shkojnë në buxhetin komunal, pastaj shpërndahet. Është shumë e vërtetë se praktika profesionale ka stagnue

në 2 vitet e fundit për shkak të pandemisë, por sido që të jetë ne do të bëjmë përpjekje që bashkarisht me juve, kryerja e praktikës profesionale të vazhdoj. Ishte edhe një pyetje tjetër për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, jo në bazë të vendimit dhe nuk është me rëndësi se kush është Kryeministër, sepse këtë çështje e rregullon ligji. Ne do ta zbatojmë këtë ligj, ku në çdo 50 punëtorë, duhet të jetë një punëtor me aftësi të kufizuara.

Bajram Hashani – Te kërkesa e znj. Valbonë, e punëtorive, si të elektroteknikës, si të makinerisë, si të kimisë, është bërë diçka në informatikë. Mirëpo, vërtetë energjetika, makineria, xehtaria dhe kimia kanë mungesa sepse 2 punëtori janë të zbrazëta, presin të mbushen me pajisje për me bë praktikën profesionale. Mendoj se është një kërkesë emergjente, që vërtetë duhet të shqyrtohet dhe mundësisht sa më shpejtë me u realizue, bile për vitin e ardhshëm akademik.

Valbonë Beka – Përveç atyre të hyrave tona, i përmenda edhe prej Ministrisë që 2 vjet që janë duke i dhënë 2 herë nga 38,600 ose 38,700 €, pikërisht vetëm për praktikë profesionale dhe kurgjë hiç nuk është bërë. Unë po them se një multimetër nuk e kemi të blerë, ose prej Komunës të ofruar diçka sepse të gjitha në mësimdhënësit duhet ti blejmë vetë. Pra, janë dikund rreth 80,000 €, për 2 vjet, që janë dhënë prej Ministrisë dhe nuk është bërë asgjë për praktikë profesionale.

Ibush Mjekiqi – Këtë, që po e thoni tani unë do ta verifikoj sepse sinqerisht nuk jam i nformuar për këto mjete. Në mbledhjen e radhës për këto 38,000 €, nga Ministria, që jepen për kryerjen e praktikës profesionale, unë do të kërkoj ose nëse, ke informacion se kur janë dhënë këto mjete, ma jepë informacionin, unë do ta verifikoj. Sido që të jetë, në mbledhjen e ardhshme përmes kryesueses do ta keni përgjegjen, por momentalisht nuk kam informacion.

Ajet Berisha – Veç me një konstatim të Nënkyetarit nuk pajtohem. Unë mund të pajtohem, sa i përket transportit, se Komuna e Obiliqit mund të bëjë marrëveshje me Komunën e Prishtinës, për transportin ndërrurban që në bazë të ligjit nënkupton transportin prej një Komune në Komunën tjetër. Ndërsa sa i përket transportit urban dhe urban periferik, në bazë të ligjit të transportit përgjegjëse është Komuna, dhe këtu Prishtina nuk ka qka me na ndihmue. Në rast se ne në Mazgit nuk kemi transport, në Graboc nuk kemi transport, as nuk kemi transport në Bakshi, Raskovë dhe Milloshevë, është çështje krejtësisht e Komunës. Kjo nuk ka të bëjë me Komunën e Prishtinës, kështu që është mirë Ekzekutivi i Komunës, në mënyrë emergjente me u marrë me këtë çështje. Procedurat qysh bëhen dihet, nuk është domosdoshmëri secila Komunë me pasë mjete të transportit për realizimin e transportit publik, por shpallin vija, shpallin tendere dhe ofrohen operatorët të cilët kanë me krye atë shërbim.

Ibush Mjekiqi – Unë thashë se qasja është multidimensionale, nuk konstatova që veç ajo duhet me bë, kështu që mos keqkuponi. Ne jemi duke punuar dhe besoj se në këtë mandate, do ta rregullojmë edhe Rregulloren dhe çështjen e transportit ku ka nevojë.

Arben Berisha – Ju informoj se në javën e kaluar jemi takuar me Kryetarin e Prishtinës, bashkë me Kryetarin z. Xhafer Gashi, i kemi organizue grupet punuese në nivel të drejtorëve. Ne do ti trajtojmë të gjitha pikat që na prekun me Prishtinën, si çështja e transportit dhe shumë çështje tjera, që i kemi të përbashkëta. Unë e di se çështjen e transportit do ta trajtojmë në takimin e radhës.

Sami Ahmeti – Pasi që veç e vërtetuat se drejtorët janë këtu, unë i kam 2 pyetje për drejtorin e shëndetësisë, sa është numri i stafit shëndetësor që punon në ndërrim të natës sepse sipas një liste në dhjetor figuron një listë që vetëm 19 prej 38 personave janë staf real që punojnë natën, në ndërkohë që 38 paguhën për ndërrim të natës në dhjetor. Ndërsa, në janar kemi një listë prej 55 personave që paguhën për ndërrim të natës, në ndërkohë vetëm 19, janë staf që punojnë natën. Sa e dijmë natën nuk punon gjinekologjia, nuk punon pediatria, nuk punojnë stafet tjera, punojnë vetëm ekipet emergjente. Në ndërkohë kemi një listë që janë paguar nga buxheti i Komunës, me të hyra vetanake, do të thotë 19 kanë qenë janë paguar 38 në dhjetor, ndërsa nga 55 në janar janë paguar vetëm 19. Këto, janë arsyt pse derisa s'ka transparencë nganjëherë ne mund të përdorim fjalë që nuk do të dëshiroja ti përdorim sepse dyshimet po ngriten në atë drejtim. Pastaj, është një veturë autoambulancë, apo çka është ajo që në janar është servisu në vlerën prej 2,300 €, së cilës iu kanë ndërrue më së paku 50 pjesë, a mund të jetë e mundur një diçka e tillë. Kjo është pyetja sa i përket Drejtorisë së shëndetësisë dhe nuk dua me vendosë askend në pozitë të keqe megjithatë,

jemi përfaqësues të qytetarëve dhe dojmë me i ngritë ato çka ne i vërtetojmë, që nuk janë në rregullë. Te Drejtoria e Arsimit, e kam një pyetje si po bëhet ndarja e orëve mësimore në shkolla, a ndodhë që mësimitdhënësve të caktuar ju përgjysmohet norma për shkak se janë të paanshëm, apo kundërshtarë të këtij pushteti për të ju siguruar një normë të plotë militantëve politikë. Është e saktë, informata se znj. Mjekiqi Kabashi, paguhet për punën që nuk e bënë, pra nukka fëmijë në klasën apo grupin që ajo do të duhej ta kishte sepse për arsye të ndryshme ato u janë shpërndarë mësueseve/kujdestareve tjera.

Kryesuesja – Sipas Rregullores së punës, neni 44, pyetja e anëtarit shtrohet në kuadër të pikës të rendit të ditës, apo te pika të ndryshme. Anëtari në një mbledhje mund të shtroj më së shumti 2 pyetje, është e caktuar me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Haki Jashari – Përgjegjet sa i përket listës së pagesës të ndërrimeve të shërbimit emergjentë, nuk ka listë e cila te ne ekziston që mund të paguhet gjinekologu, ose dikush që nuk e meriton pagesën. Sa i përket ndërrimeve të natës, shërbimit emergjentë mund të ketë dallime lidhur me pagesën për arsye se shumë herë në shërbimin emergjentë ne angazhojmë edhe staf tjetër, që për shkaqe të procedurës nuk janë në listë, nuk e kanë kodin dhe nuk mund ta gëzojnë të drejtën e pagesës. Mirëpo, atë e shpërblejmë me dhënien e ditëve të lira. Ju siguroj me bindje të plotë se nuk ka ndonjë keqpërdorim. Sa i përket dhënies së mjeteve meqenëse, kemi një staf i cili tejkalon fondin e orëve, varësisht neve si na duhen, nëse nuk e ke ngatërrue me shtesën që na ka dhënë Ministria prej 10 %, të cilën e ka sanksionue nga rrezikshmëria tash në pagën shtesë. Unë kisha pasë dëshirë sinqerisht që nëse, ka diçka me pa dhe me ditë, QKMF-ja, është e hapur dhe çka do që keni mund të vini e të na vizitoni, mund të na pyetni, mund të ju japim shpjegime të cilësdo natyre qofshin ato. Mirëpo, nuk ka keqpërdorime te pagesat e shërbimit emergjentë, apo stafit tjetër.

Sami Ahmeti – Mund të jetë që mos të ketë ndonjë keqpërdorim apo diçka të tillë psh kjo lista me dt.10.01, që ia ke drejtue thesarit z.Ahmet Tolaj, nga ana juaj kërkojmë që të bëni ekzekutimin e pagesave të ndërrimeve të natës për punëtorët shëndetësorë. Në këtë listë janë 38 emra, ndërsa ka emër të pediatrave, ka emër të gjinekologëve. Këtu, shkruan ndërrimi i natës.

Haki Jashari – Sqaron se ne kemi festa dhe e angazhojmë pediatrin me punue, kemi festa që e angazhojmë ekipin së paku prej 3 mjekëve dhe stafi tjetër mbështetës, jo të natës por është lista e njejtë që shkon edhe e festave dhe e ndërrimit të natës.

Sami Ahmeti – Pyeti pse nuk ceket që është e ndërrimeve të natës.

Haki Jashari – Përgjegjet se shkojnë në një vend të gjitha dhe nuk ka mundësi sepse ne i kemi festat, për të cilat jemi të obliguar sipas ligjit me i pague. Urdhnoni, ejani në shërbimin e administratës, mud ti shikoni dhe ti vërtetoni. Nuk qëndrojnë ato asnjë dhe dyshimet largoni. Unë edhe vetë punoj natën në ora 2 dhe 4, shkoj të shtunën dhe të dielën dhe kurrë nuk jam në listë.

Sami Ahmeti – Jeni në listë të pagesës së rrezikshmërisë, çfarë rrezikshmërie përbën puna e juaj, pjesëmarrja në seanca apo në punët tjera, që nuk kanë të bëjnë me sistemin shëndetësor

Haki Jashari – Përgjegjet se pak është komplekse shëndetësia dhe duhet me i pasë informatat e argumentuara të çështjeve. Që nga fillimi i pandemisë unë e udhëheqi ekipin e epidemiologjisë dhe te ankesat, anketimit të rasteve, unë jam që kam hy nëpër shtëpia kur ishin rastet pozitive, para së gjithash unë jam mjek. Lista e pagesës shtesë është për të gjithë punëtorët shëndetësorë, pavarësisht pozicionit që e kanë duke filluar prej drejtorit deri te higjienistët, është edhe logjistika dhe janë të gjithë. Ju i keni ngatërrue pozicionet.


Kryesuesja – Nuk ka të drejtë të shtrohen më shumë se 2 pyetje nga i njejtë anëtarë i Kuvendit dhe këtu, u paraqitën më shumë se 2 pyetje. Drejtoria e Arsimit, e mori pyetjen edhe pse ishte pyetja e tretë e parashtruar dhe në seancën e radhës së Kuvendit, mundeni me shkrim të përgjegjeni, ose jo sepse është në kundërshtim me Rregulloren e punës së Kuvendit komunal..

Mbledhja përfundoi në ora 11:33'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi

